Kronikë

Vrasja e dyfishtë në Lezhë, viktimat sapo ishin kthyer nga Italia! Ish-dhëndri i dënuar në Itali për dhunë, kishte 6 vite që ishte divorcuar nga gruaja

Burime për Report Tv bëjnë me dije se autori i ngjarjes Besnik Pjetrin nga fshati Troshan, ishte baba i dy vajzave dhe prej 6 vitesh ishte i divorcuar nga bashkëshortja! Në kërkim autori

■ Babë e bir u vranë nga ish-dhëndri, flasin fqinjët

Redaksia
30 Gusht, 07:36 | **Përditesimi i fundit: 30 Gusht, 11:31**

LEZHË- Babë e bir u ekzekutuan me armë zjarri nga ish-dhëndëri i tyre në Lezhë. ***Krimi i rëndë ndodhi*** rreth orës 23:00 të mbrëmjes të së hënës në fshatin Gryk Zezë, ndërsa viktimat janë Pjerin Përjaku 56-vjeç dhe Gent Përjaku 32-vjeç. Ndaj tyre u qëllua me breshëri plumbash sapo kishin hyre në oborrin e banesës së tyre dhe nga plagët e marra gjeten vdekjen e menjëhershme. Policia e cila mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes identifikoi autorin, por pa arritur që ta prangosë. Ai është Besnik Pjetri 45-vjeç banues në Troshan i cili pas krimit është larguar, duke i shpëtuar policisë. Policia bën me dije se për kapjen e tij po krihet e gjithë zona si dhe po ushtrohen kontrolle në vendet nga ku mendohet se mund të jetë fshehur.

Ndërkohë nga veprimet hetimore të kryera në vendin e ngjarjes dhe mbledhjes së dëshmive, bëhet me dije se babë e bir ishin kthyer të hënën nga Italia ku jetonin prej shumë vitesh, pasi kishin patur një dasëm në vendlindje tek disa të afërm të tyre. Siç duket ish-dhëndri i ka ndjekur lëvizjet e objektivave të tyre dhe sapo janë kthyer në banese është afruar dhe ka qëlluar me breshëri plumbash. Fqinjët e familjës Përjaku thonë se janë të tronditur nga kjo ngjarje e rëndë, ndërsa nuk kishin patur dijeni që babë e bir ishin kthyer nga Italia ku jetonin e punonin prej më shumë se 20-vitesh.

LEXO EDHE:
U vra nga ish-burri i motrës, kush është 32-vjeçari Gent Përjaku

Sipas burimeve autori i ngjarjes Besnik Pjetri i cili ishte babai i dy vajzave ishte divorcuar, prej më shumë se 6 vitesh nga gruaja e tij dhe që prej asaj kohë kishte patur konflikte të vazhdueshme më ish-gruan dhe familjen e saj, madje për këtë çështje ishte arrestuar dhe nga policia në Itali dhe kishte qëndruar për rreth 2 vite në burg. 45-vjeçari pretendonte se familje e ish-nuses së tij i kishte borxhe dhe nuk ja kishin kthyer, ndërsa së fundmi nuk e kishin lejuar të takonin as vajzat çka dyshohet të jetë bërë shkak dhe për krimin e rëndë.

Në përditësim...

Autori Besnik Pjetri dhe një nga viktimat Gent perjaku

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:29
U vra nga ish-burri i motrës, kush është 32-vjeçari Gent Përjaku

Report Tv ka siguruar foton e 32-vjeçarit Gent Përjaku i cili u vra me armë zjarri nga Besnik Pjetri, ish-burri i motrës së tij. Viktimë ka mbetur edhe babai i tij 56-vjeçari Pjerin Përjaku.

Ora 08:47
Vrau babë e bir në Lezhë, Report Tv siguron foton e Besnik Pjetrit

1 / 5

Autori i krimit Besnik Pjetri

Report Tv ka siguruar foton e Besnik Pjetrit, i cili vrau me armë zjarri mbrëmjen e kaluar ish-vjehrrin e tij dhe kunatin, Pjerin e Gent Përjaku. Megjithëse kishte 6 vite i ndarë nga gruaja, ato kishin pasur vazhdimisht konflikte.

Ora 08:26
Babë e bir u vranë nga ish-dhëndri, flasin fqinjët: Prej 20 vitesh jetonin në Itali, mbrëmë ishin kthyer

Fqinjët e Pjerin Përjakut dhe Gent Përjakut (babë e bir) të cilët u vranë më armë zjarri nga ish-dhëndri i tyre kanë folur për Report Tv. Ato kanë treguar se babë e bir jetonin e punonin prej 20 vitesh në Itali.

> *'Na thanë është bërë nami i zi. Janë vendali të ka hershëm.'- u shpreh një fqinje.*
>
> *'Ka disa vjet që kanë ikur në Itali. Mbrëmë më duket se ka ardhur. Më ka ardhur shumë keq se e kam pas shumë dashamirës. Kanë jetuar në Itali për nja rreth 20 vjet. Ka pas ardhur i shkreti. Ka qenë person i papamë si familje, taksirati të gjen.'- u shpreh një fqinj tjetër.*

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: gent perjaku | besnik pjetri | Lezhe | pjerin perjaku

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Marrëveshja për të njohur letërnjoftimet, e besoni se Serbia do e njohë Kosovën si shtet së shpejti?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Opinion

Enigma e artikullit 'Dosja EXEL'që zbulon vrasesit e Santos dhe çfarë lidhje ka Ervis Martinaj?
Arben Meçaj
30 Gusht, 11:22

Kronikë

I kërkuar nga Turqia pasi kishte mashtruar mijëra turq, Faruk Ozer u arrestua në një resort luksoz në Palasë
30 Gusht, 11:16

Opinion

Gazetari investigativ dhe thashethemi investigativ
Edmond Arizaj
30 Gusht, 11:13

Opinion

Ylli që trazoi rrjetin dhe opozitën
Altin Ketro
30 Gusht, 11:10

Kronikë

Aksidenti në aksin Fier-Vlorë, Report Tv siguron detaje si ndodhi ngjarja! Shoferin e kishte zënë gjumi në timon
30 Gusht, 11:02

Politikë

Lorenc Vangjeli: Shqiptarëve nuk iu duhet revolucioni, por ekuilibri i pushteteve
30 Gusht, 10:57

Bota

Pas apelit të Ukrainës, BE diskuton sot për ndalimin e hyrjes për turistët rusë
30 Gusht, 10:47

Kronikë

Lirohet nga burgu ish-drejtori RTSH-së Thoma Gëllçi
Arsen Rusta
30 Gusht, 10:35

Kronikë

Bëri mashtrimin më të madh në historinë e Turqisë, kush është turku Ozer, pronari i kriptomonedhës turke 'Thodex'!
30 Gusht, 10:28

Kronikë

I vodhi makinën një qytetareje, në pranga 34-vjeçari i dënuar më parë për vjedhje
30 Gusht, 10:17

Kronikë

U arratis me 2 mld $ nga Turqia, i vihen prangat në Palasë bosit të kriptomonedhave turke Faruk Ozer! Në pranga edhe nipi Armando Dukës që e ndihmoi të fshihej
30 Gusht, 10:07

Sport

FSHF publikon çmimet e biletave për ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Islandës, ja sa do të kushtojnë
30 Gusht, 09:56

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje